“Sa e sa flokëshprishurve (të pluhurosurve), që refuzohen nga dyert e njerëzve, po qe se i betohen Allahut, Ai ua realizon betimin.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Sa e sa flokëshprishurve (të pluhurosurve), që refuzohen nga dyert e njerëzve, po qe se i betohen Allahut, Ai ua realizon betimin.”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi se mes njerëzve ka prej atyre që kanë flokë të çrregullt e të pluhurosur, të cilët nuk i lyejnë me vaj dhe nuk i lajnë shpesh. Ata nuk kanë pozitë në sytë e njerëzve; largohen nga dyert dhe refuzohen për shkak të përçmimit. Megjithatë, sikur të betoheshin për diçka, Allahu do ta përmbushte betimin e tyre për nder të tyre, duke ua pranuar kërkesën, dhe duke i ruajtur që betimi i tyre të mos dalë i pavërtetë, për shkak të vlerës dhe pozitës së tyre tek Allahu.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/3715